



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 11381 prot.

Tiranë, më 8.5.2019

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi

DREJTORIVE NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 921 datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

Komandant Grupi, Sektori i Antikontrabandës Tokësore, Drejtoria Antikontrabandës pranë Departamentit Operativ Hetimor, Kategoria C1, Kategoria e Pagës III-b, 5 (pesë) vende pune

Kandidatët që do të aplikojnë duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë shtetësi shqiptare
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre
4. Të mos kenë qenë të dënuar me vendim penal të formës së prerë
5. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze
6. Të zotërojnë diplomë të nivelit Master Profesional në Shkencat Ekonomike, Juridike, Natyrore, të lidhura me Sigurinë dhe Hetimin, Akademi Ushtarake/Policore
7. Përvojë pune deri në 1 (një) vit
8. Të ketë njohuri të paktën të një gjuhe të huaj.

Avantazhe:

Të ketë njohuri në fushën doganore.

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

- Vepron si Kreu i Grupit të Antikontrabandës Tokësore dhe përgjigjet drejtpërsëdrejti para Përgjegjësit të Sektorit të Antikontrabandës Tokësore dhe Drejtorit të Drejtorisë së Antikontrabandës.
- Siguron hartimin e një strategjie dhe planeve të një niveli Grupi dhe të detajuara, si dhe garanton se objektivat janë përmbushur brenda afateve kohore
- Vendos para përgjegjësisë ligjore të gjithë ato subjekte që kryejnë veprime të paligjshme për t'ju shmangur kontrollit doganor ose që kryejnë cdo lloj trafikui të paligjshëm
- Kontrollon në aks-rrugor dokumentacionin e mallrave, të mjeteve, që hyjnë nga zona doganore drejt territorit shqiptar.
- Përcakton me rrisht mjetet përkatëse, kur ka arsye apo dyshime se në to mund të ketë diferenca në sasi peshë, shmangje në natyrë malli, apo mangësi të tjera në dokumentacion.
- Përpilon dokumentacionin përkatës në rastin e konstatimit të shkeljeve doganore dhe ja dorëzon atë Kryetarit të Degës Doganore për marrjen e vendimit përkatës.
- Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga akte ligjore, nënligjore, rregullore, dhe dokumenta të tjera

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje e Diplomës dhe Lista e Notave të noterizuara (*Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit*)
4. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore /dëshmi penaltiteti
5. Vërtetim nga Gjykata
6. Vërtetim nga Prokuroria
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore
9. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Letër reference dhënë nga eprori direkt i pozicionit të fundit të punës
12. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e konkurimit do të zhvillohet në dy faza.

Në fazën parakualifikuese kandidatët do të vlerësohen nga dokumentacioni i paraqitur nëse plotësohen kërkesat për konkurim. Aplikantët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë do të vijojë me kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në:

- a) Pervojën
- b) Kualifikimin
- c) Aftësitë

Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Rezultatet e konkurimit

Lista me kandidatët fitues, do të shpallet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 18.05.2019, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/ Zyra Sekretari/Protokollit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arlind Gjokuta

